



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 24.04.2026

PËR
REFUZIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT HOTELERI 3, 5 DHE 11 KATE MBI TOKË ME 2 KATE NËNTOKË ”
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KAVAJË

1. Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 10/2 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

2. Refuzimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt hoteleri 3, 5 dhe 11 kate mbi tokë me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vizion Turizëm 2023” sh.p.k.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29 04 / 2026